



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 10 dhjetor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1323_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin ngastra kadastrale nr. 666/10 ZK Klinë me kapacitet të instaluar prej 8 kW në Komunën e Klinës, të datës 26.11.2020 me nr. prot. 717/20 të aplikuesit personit fizik Mark Coli, me adresë: Rr. "Jeronim De Rada" Komuna Klinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 10 dhjetor 2020 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit personit fizik Mark Coli për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin ngastra kadastrale nr. 666/10 ZK Klinë me kapacitet të instaluar prej 8 kW në Komunën e Klinës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi personi fizik Mark Coli me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPE-9026947 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi personi fizik Mark Coli do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 26.11.2020 nga aplikuesi personi fizik Mark Coli, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga



panelet solare/fotovoltaike, në objektin ngastra kadastrale nr. 666/10 ZK Klinë me kapacitet të instaluar prej **8 kW** në Komunën e Klinës.

- o Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 9568 të datës 25.11.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin 06 Nr. 350-12734/2020 dt. 23.06.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit dhe mbrojtje të Mjedisit Komunës së Klinës.
- o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit personit fizik Mark Coli dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin ngastra kadastrale nr. 666/10 ZK Klinë me kapacitet të instaluar prej **8 kW** në Komunën e Klinës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Klinës,
- KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.